URDHËR
Nr. 299, datë 1.10.2020

PËR NGARKIMIN E PËRKOHSHËM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 22, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; nenit 28, germa "d", të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", si dhe nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Ngarkimin e përkohshëm të z. Alqi Kushi në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë që nga data 25.9.2020.
2. Ky zëvendësim nuk shoqërohet me efektet financiare të pozicionit Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi